



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/194
Datë: 20.03.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 95, paragrafit 2. të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.05/L-068 dhe me Ligjin Nr. 05/L-092, të nenit 3, paragrafit 1. të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2018 për Zbatimin e Procedurave Qendrore të Prokurimit Publik, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 mars 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet lista e artikujve për përdorim të përbashkët që janë objekt i procedurës qendrore të prokurimit publik, e aprovuar sipas pikës 1. të Vendimit të Qeverisë Nr. 06/27 të datës 30 prill 2020, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 07/140 të datës 26 prill 2023 dhe me Vendimin Nr. 13/148 të datës 29 qershor 2023, me listën e bashkëngjitur në Shtojcën 1. të këtij Vendimi.
2. Pikat tjera të Vendimit të Qeverisë Nr. 06/27 të datës 30 prill 2020, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 07/140 të datës 26 prill 2023 dhe me Vendimin Nr.13/148 të datës 29 qershor 2023, mbesin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Shtojca I

Artikujt dhe Shërbimet që janë pjesë e prokurimeve të përbashkëta

Përshkrimi i artikullit	Lloji i kontratës	Kohëzgjatja
1. Furnizim me letër për kopje	Kontratë Kornizë	2 Vite
2. Furnizim me material zyrtar	Marrëveshje Kornizë	3 Vite
3. Furnizim me vetura të udhëtarëve	Kontratë Kornizë	1 Vit
4. Furnizim me artikuj ushqimor	Kontratë Kornizë	1 Vit
5. Furnizim me mobile	Kontratë Kornizë	1 Vit
6. Furnizim me pajisje të teknologjisë informative (Marrëveshje kornizë)	Marrëveshje kornizë	3 Vite
7. Furnizim me pemë dhe perime (Marrëveshje kornizë)	Marrëveshje kornizë	3 Vite
8. Veturat me qira	Kontratë Publike Afatgjate	5 Vite
9. Shërbime fotokopjimi, skanimi dhe printimi – me qira	Kontratë Publike Afatgjate	3 Vite
10. Furnizim me karburante	Kontratë Kornizë	1 Vite
11. Furnizim me mazut	Kontratë Kornizë	2 Vite
12. Furnizim me ujë të pijes	Kontratë Kornizë	3 Vite